Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**
_____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofuara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	6	7
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Njësia	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(4 x 5)	Afati i Marrëveshjes Kuadër
1	Sistem IVR	Copë	1			
2	Trajnim – 5 ditë	Shërbim	15			
Vlera pa TVSH						
Fondi limit i marreveshjes kuader:				8,183,333 lekë pa TVSH		
Çmimi Neto pa TVSH						
TVSH (%)						
Çmimi total me TVSH:						
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit						

Nënshkrimi				
Vula				
Datë _____				

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Zgjidhja duhet të jetë web-based dhe të mbështesë ndërveprimet zanore dhe dixhitale, rutimin inteligjent (ACD), menaxhimin e plotë të agjentëve dhe mbikëqyrësve, vetë-shërbimin përmes IVR, si dhe raportim dhe analitikë të avancuar.

Platforma duhet të ofrojë **agent desktop** të bazuar në web browser, **IVR të personalizueshëm, routing sipas ekspertizës, raportim real-time/historik**, dhe integrim të plotë me sistemet ekzistuese të ticketing dhe API të IdentiTek.

Kapaciteti fillestar parashikon deri në **25 agjentë aktivë**, me mundësi zgjerimi në fazat e mëvonshme.

1. Aftësitë Themelore të Softuerit

2.1 Menaxhimi i Agjentëve /

Ndërveprimeve

- Desktop i bazuar në shfletues për agjentët: menaxhim i seancave të shumta, kontroll thirrjesh, statuse pune, wrap-up, ekran pop-up/CRM i integruar
- Desktop për drejtuesit: monitorim në kohë reale, dëgjim i heshtur, këshillim me zë të ulët, mesazhe grupore, kontroll i gjendjes së ekipit
- Çdo biletë hyrëse/dalëse shfaqet si pop-up për krijimin e një service ticket-i me kategori dhe nënkategori të edituara nga menaxheri, duke përfshirë fushën e detyrueshme NID.
- Rol dedikuar për mbikëqyrësit (Supervisor Desktop): monitorim i agjentëve në kohë reale, dëgjim i heshtur, whisper coaching, ndërhyrje (barge-in), menaxhim statusi dhe komunikim me ekipin.
- Menaxhim rolesh dhe autorizimesh sipas politikave të institucionit.

2.2 Routimi i Thirrjeve dhe Kontakteve

- Routim inteligjent ACD bazuar në aftësi (Skill-Based Routing), llojin e kontaktit, orarin e punës dhe përparësitë e përcaktuara.
- Mekanizëm RONA me timeout të konfiguruar (p.sh. 10–15 sekonda), duke ridrejtuar thirrjen tek agjenti tjetër i disponueshëm ose tek supervizori në rast overflow-i.
- Balancim dinamik i ngarkesës sipas disponueshmërisë dhe performancës së agjentëve.
- Routing i personalizuar sipas departamenteve dhe profileve të ekspertizës (IVR Queue Profiles), duke optimizuar shpërndarjen e thirrjeve sipas rregullave të biznesit dhe SLA-ve.

2.3 Vetë-Shërbim dhe IVR

- Redaktues vizual për rrjedhën e thirrjeve (bazuar në GUI)
- Hyrje DTMF, luajtje e regjistrimeve zanore, logjikë kushtetuese
- Opsionale: njohje e të folurës (ASR), sintetizim i zërit (TTS), mbështetje për aplikacione VoiceXML


- Integrim me databaza ose API HTTP për vetë-shërbim: kërkesa/përgjigje, kërkim të dhënash, validim NID etj.
- Përgjigje automatike për skenarët informativë të parapërgatitur nga IdentiTek, duke ofruar vetë-shërbim për kërkesat standarde pa përfshirjen e agjentit.

2.4 Raportim dhe Analizë

- Dashboard real-time me metrika të radhëve (queue), gjendjen e agjentëve, SLA, AHT, FTR dhe abandon rate.
- Raporte historike për aktivitetin e agjentëve, volumin e thirrjeve, rezultatet e kontakteve, koha e përgjigjes dhe koha e pritjes.
- Ndërtues raportesh të personalizuar me mundësi eksportimi CSV/SQL dhe integrim me mjete të jashtme BI përmes API.
- Raporte të detajuara në nivel përdoruesi (user-level) me metrika si numri i thirrjeve, koha mesatare e përgjigjes, thirrjet e humbura/anuluara, koha e pritjes dhe First Time Resolution.
- Statistika të avancuara për ndjekjen e volumit të thirrjeve, kohës totale në thirrje dhe performancës së stafit, me dashboard dhe eksportim të dhënash.

2.5 Rrjedha IVR dhe Menaxhimi i Rradhëve

- Sistemi duhet të mbështesë dy rrjedha IVR të ndara: (1) për qytetarët; (2a) për operatorët e regjistrimit në AL; (2b) për operatorët në përfaqësi diplomatike, me regjistra të agjentëve të edituar nga menaxheri i njësisë.
- Workflow-i i plotë i IVR është përshkruar në diagrame e parqitur me poshtë”:



- Menaxhim i radhëve me monitorim të statusit në kohë reale, opsion pritjeje kur të gjithë agjentët janë të zënë dhe informim të klientëve deri në disponueshmërinë e një agjenti.
- Protokolle të qarta eskalimi për thirrjet që kërkojnë asistencë të avancuar, duke i dërguar tek specialistët e regjistrimit sipas rregullave të biznesit.

-
- Raportim i minutave hyrëse/dalëse për thirrjet inbound dhe outbound, me kapacitet për të planifikuar trafikun dhe burimet.
 - Krijimi i profileve të agentëve sipas ekspertizës/grupeve, të lidhura me IVR Queue për të optimizuar rutimin dhe shërbimin.

3. Kërkesat për Infrastrukturën

3.1 Platforma Virtualizimi

- Hypervisor të mbështetur: **VMware ESXi 7.x / 8.x**
- Deploy përmes **appliance virtuale** ose **OVA** të certifikuar nga prodhuesi
- Sistemi operativ: Linux i siguruar (AlmaLinux 8 / CentOS 7)
- HA: Cluster me dy nje dhe failover automatik.

3.2 Përmasimi i VM-ve

- Deri në 25 agentë: 2 vCPU, 10–14 GB RAM, 1 x 146 GB disk
- Dimensionimi fillestar duhet të mbulojë deri në 25 operatorë aktivë, me opsion për të shtuar operatorë dhe linja shtesë sipas kërkesës.

4. Integrimi me Telekomunikacionin

4.1 Kontrolli i Thirrjeve

- Integrim me PBX SIP
 - Mbështetje për **rutimin e thirrjeve hyrëse dhe dalëse**, duke përdorur protokollin standard SIP (RFC 3261).
 - Integrim me **gateway** ose **SIP Trunk** për akses në rrjetin PSTN/PLMN.
 - Mbështetje për mekanizmin **Click-to-Call** nga aplikacione web ose sisteme të brendshme, duke inicializuar thirrjet përmes API-ve të platformës.
 - Normalizim i numrave sipas planit të numeracionit (E.164).

5. Pajisje të Mbështetura

5.1 Pajisjet e Agentëve

- Softphone i integruar në shfletues, bazuar në teknologjinë **WebRTC** (pa instalim lokal).
- Nuk kërkohen telefona fizikë; thirrjet kryhen nga browser-i i agentit.
 - Mbështetje për **kufje të certifikuara** (USB ose Bluetooth) me mikrofon të integruar dhe anulim të zhurmës.
 - Qasje e sigurt nga rrjeti i institucionit ose nga lokacione të tjera, **pa nevojë për VPN**, përmes protokolleve të enkriptuara HTTPS/WSS.

5.2 Të Supportoje web browser

Chrome, Edge, Firefox (dy versionet më të fundit); mbështetje e plotë për WebRTC (Opus, DTLS-SRTP)

6. Siguria dhe Përputhshmëria

- Enkriptim fund-me-fund i trafikut të të dhënave dhe sinjalizimit përmes **TLS 1.2+/HTTPS/WSS**.
- Enkriptim i mediave zanore përmes **SRTP**, me negociim të kufizuar të cipher-ave.
- Kontroll aksesi me role (**RBAC**) për agentë, mbikëqyrës, administratorë dhe auditorë.

- Mbështetje për autentifikim të unifikuar (SSO) përmes **SAML 2.0** ose **OAuth2/OpenID Connect**.
- Regjistrime (audit logs) të detajuara për çdo veprim, me mundësi eksportimi në sisteme të **SIEM** për detektim anomalish dhe analiza sigurie.
- Pajtuueshmëri me politikat e brendshme të institucionit dhe standardet e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave.

7. Integrim dhe Zgjerim

- **API REST** për kontroll, raportim, krijim biletash, kërkesa të IVR, integrim të të dhënave dhe automacioni.
- Integrim me sisteme të jashtme CRM përmes HTTP(S) dhe API-ve (REST/JSON), për shkëmbim të të dhënave të kontaktit dhe rezultateve të thirrjeve.
- Mbështetje për lidhje me **mjetet e sondazheve**, chatbot, sisteme të menaxhimit të dokumenteve dhe module të tjera të zgjerueshme.
- Arkitekturë modulare që mundëson zgjerimin me **kanale dixhitale** (chat, email, SMS, social media) dhe me funksionalitete të automatizuara (dialer, robotikë IVR).
- Integrim natyral me sistemin e ticketing të institucionit, me krijim automatik bilete nga rrjedhat IVR, aktualizim të statusit dhe sinkronizim të të dhënave të qytetarëve (përfshirë NID)

8. Karakteristika dhe Përfitime

8.1 Përvoja e Agjentit dhe Mbikëqyrësit

- Ndërfaqe moderne e agjentit, e bazuar në shfletues, me dizajn të personalizueshëm dhe funksionalitete të integruara për telefonata, chat, email dhe screen-pop nga sistemi CRM/ticketing.
- Mbështetje e plotë për punë në distancë, pa VPN, përmes WebRTC dhe pajisjeve standarde të përdoruesit (laptop/desktop + kufje).
- Panel i mbikëqyrësit (Supervisor Console) me monitorim real-time të agjentëve, dëgjim të heshtur, whisper coaching, ndërhyrje në thirrje (barge-in), si dhe kontroll të statusit të ekipit.
- Vizualizim grafik i performancës së ekipit përmes dashboards dhe metrikeve operative.

8.2 Disponueshmëri dhe Shkallëzueshmëri

- Arkitekturë me qëndrueshmëri të lartë (HA), që siguron failover automatik për komponentët e thirrjeve, IVR-së, backend-it dhe raportimit.
- Shkallëzim horizontal dhe vertikal, që lejon zgjerimin nga 20 deri në 400 agjentë brenda të njëjtit mjedis virtual, pa ndërprerë shërbimin.
- Shtim dinamik i linjave të thirrjeve dhe licencave të agjentëve sipas rritjes së trafikut.

8.3 Funksionalitete të vetë-shërbimit dhe automatizimit

- Redaktues IVR me ndërfaqe grafike (GUI), që mundëson ndërtimin e rrjedhave të thirrjeve pa kodim dhe me fleksibilitet të lartë për logjikë kushtëzuese.
- Mbështetje për ASR dhe TTS (opsionale), si dhe integrim me databaza, API të jashtme ose aplikacione për vetë-shërbim të qytetarëve.
- Përdorim i teknologjive të AI/chatbot për trajtimin e kërkesave standarde dhe uljen e ngarkesës mbi operatorët përpara eskalimit të agjentët.

8.4 Siguria dhe Përputhshmëria

- Autentifikim i unifikuar (SSO) përmes SAML 2.0 ose OAuth2 / OpenID Connect.

-
- Kriptim fund-me-fund i sinjalizimit dhe mediave (TLS 1.2+, SRTP), në përputhje me standardet ISO dhe FIPS për sigurinë e informacionit.
 - Auditim i plotë i veprimeve, me logje të strukturuar të eksportueshme drejt sistemeve SIEM për detektim anomalish dhe analizë sigurie.
 - Regjistrim i plotë i thirrjeve hyrëse dhe dalëse, me ruajtje të enkriptuar, politikë të kontrolluar aksesimi dhe mbështetje për kërkesa ligjore për ruajtje të dhënash.

8.5 Raportim dhe Analitikë

- Raporte operative dhe historike në kohë reale, me mundësi eksportimi ose integrimi me mjete të jashtme BI përmes API.
- Mbështetje për sondazhe pas-thirrjes (CSAT/assessment) përmes SMS, IVR ose email, me raportim të rezultateve dhe korelim me thirrjet përkatëse.
- Konfigurim i pyetësorëve CSAT sipas departamentit, fushatës ose IVR path, me opsione për analiza të thelluara të përvojës së qytetarëve.
- Metrika të avancuara për planifikim burimesh (AHT, FTR, occupancy, abandon rate, SLA compliance).

8.6 Integrim dhe Zgjerim

- **API REST** për integrim me sistemet CRM, helpdesk, aplikacione të palëve të treta, chatbot dhe module të tjera të automatizimit.
- Mbështetje për **kanale të shumta komunikimi** përmes zgjerimeve modulare: web chat, email, SMS, social media dhe kanale të tjera dixhitale.
- Arkitekturë e hapur, fleksibël dhe e dokumentuar, e cila mundëson integrim natyral me sistemet ekzistuese të institucionit për komunikim, menaxhim operativ dhe raportim.
- Kapacitet për të shtuar funksionalitete të reja pa ndërprerë shërbimin (module plug-in / service adapters).

8.7 Menaxhim Operacional dhe Cilësi

- Program trajnimi i dedikuar për operatorët dhe mbikëqyrësit, përfshirë përdorimin e platformës, procedurat e IVR-së dhe protokollat operative.
- Monitorim i cilësisë në kohë reale dhe historike: kohëzgjatja e thirrjeve, koha e pritjes, rezultatet e ndërveprimeve dhe metrika të SLA-ve, me alarme kur ka devijime.
- Implementim i moduleve të menaxhimit të radhëve dhe performancës (Queue Management / Workforce Performance), për të reduktuar kohët e pritjes dhe për të prioritetizuar thirrjet urgjente.
- Opsione për analiza të avancuara të performancës së stafit dhe kapaciteteve operative.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

1	2	3	4	5
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Njësia	Sasia	Afati i kontratës
1	Sistem IVR	Copë	1	
2	Trajime – 5 ditë	Shërbim	15	

Grafiku i Ekzekutimit:

Nr.	Pershkrimi	Java 1	Java 2	Java 3	Java 4
1	Faza 0 – Planifikimi	X			
2	Faza 1 – Zhvillimi dhe Implementimi i Sistemit		X	X	
3	Faza 2 – Transferim njohurish, dokumentim, marrje në dorëzim				X

Përshkrimi narrativ i fazave të implementimit

- Faza 0 – Planifikimi:** Pas nënshkrimit të kontratës aktivizohet ekipi i projektit, finalizohet kalendari i implementimit dhe vendoset instanca bazë e platformës në mjedisin on-premise të Identitek. Përfshihet rezervimi dhe regjistrimi ligjor i numrit unik per IdeniTek, si dhe konfigurimet fillestare të sigurisë dhe aksesit.
- Faza 1 – Zhvillimi dhe implementimi i platformës:** Organizohen 3 ditë workshop me grupet e punës për harmonizimin e kërkesave funksionale, modelimin e proceseve dhe miratimin e logjikës së IVR për qytetarët, operatorët vendorë dhe përfaqësitë diplomatike. Aktivizohet API e integritit me sistemin e ticketing, konfigurohet hapja automatike e biletave në bazë të NID dhe dokumentohet integrimi end-to-end.
- Faza 2 – Transferimi i njohurive dhe pranimi:** Zhvillohen 5 ditë trajnim (40 orë) për operatorët dhe drejtuesit e Identitek, me module teorike dhe praktike. Realizohen testime vlerësuese dhe përgatitet procesverbali final i pranimit të platformës.

Afatet e ekzekutimit: do të jetë 1 (një) muaj duke nisur nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Sistemi Interactive Voice Response (IVR)”**.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Ne ambjentet e zyrave qendrore te ”IdentiTek” SH.A

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10**;

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose versione të përditësuara/ekuivalente), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë **ISO/IEC 27001:2022** (ose versione të përditësuara/ekuivalente), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
 - b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 3 (tre) punonjës të kualifikuar dhe certifikuar për realizimin e këtij shërbimi, si vijon.
 - 1 (një) Inxhinier Telekomunikacioni ose Teknologji Informacioni ose Shkenca kompjuterike
 - 1 (një) punonjës specialist IT, me profil Teknologji Informacioni ose Informatik Ekonomike ose Shkenca Kompjuterike.
 - 1 (një) punonjës i certifikuar që kryen trajnim për programin e ofertuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën përkatëse
- Kontratën e punës e vlefshme ose kontratë bashkëpunimi
- CV përkatëse
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore;

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimene vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj.

nuk janë të dën timer me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dën timer dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

